



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1991/2 Prot

Gramsh më 31.05.2022

V E N D I M

Nr. 46, datë 31.05.2022

“PËR

**PJESËMARRJEN E BASHKISË GRAMSH NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, nenit 12 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura", të ndryshuar, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjetllës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Gramsh”sh.a, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Gramsh”sh.a,” për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktor dhe noterial me qëllim transferimin e veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë .

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë ) ditë pas shpalljes

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI

Konc.Xh.Gjini  
Miratoi G.Lena  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Greta LENA

